

Kthim pergjigje Nr. 159 Mon 2/24/2020 11:36 AM

To:kkeruti@partnersalbania.org;

...

Përshëndetje Zj. Keruti!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 159 në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju sqarohet si më poshtë vijon:

- Numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara gjatë vitit 2019 është 238 ((bashkëngjitur lista e plotë).
- Aktualisht numri total i organizatave jofitimprurëse është 4777 (bashkëngjitur lista e plotë).
- Organizatat jofitimprurëse të ndara sipas statusit aktual janë: aktiv 2212, pasiv 2353, çregjistruar 177, kërkesë për çregjistrim 35.
- Numri i organizatave jofitimprurëse, me përgjegjësinë tatimore të TVSH-së, në total është 1562 (listën e plotë si dhe statusin e kësaj përgjegjësie e gjeni bashkëlidhur).
- Numri i të punësuarve në organizatat jofitimprurëse aktualisht është 9966 (nga informacioni që disponojmë, nuk kemi të dhëna në lidhje me punonjësit e punësuar me kohë të pjesshme, si dhe vullnetarë).
- Numri total i organizatave jofitimprurëse që kanë qënë objekt kontrolli të plotë gjatë vitit 2019 është 12.
- Numri i çertifikatave të regjistrimit për efekt rimbursimi të TVSH-së në kuadër të projekteve IPA, financuar nga Bashkimi Europian, të lehuara nga Administrata Tatimore, është 19.
- Numri total i organizatave jofitimprurëse me detyrime të papaguara gjatë 30 ditëve është 359 me detyrim 10.045.000 lekë.
- Borxhi total i organizatave jofitimprurëse, në datë 17.02.2020, është 332.463.000 lekë nga 2292 organizata jofitimprurëse.

Faleminderit për mirëkuptimin.